

"PRISHTINA ENERGJETIKE"



Projekti "Taslixhe 4"

"Taslixhe 4" është projekt në kuadër të megaprojektit investiv në rajonin e Prishtinës.

Plani investues i KEDS në Prishtinë përfshin rritjen e kapaciteteve të linjave ekzistuese nga 10 kV në 20 kV, krijimin e linjave alternative, futjen nën tokë të 90% të rrjetit të tensionit të mesëm, zëvendësimin e 50% të linjave të tensionit të ulët. Nga këto investime do të përfitojnë direkt 90 mijë konsumatorë.

Të dhëna specifike për projektin: Demolimi i 90 shtyllave, vendosja e 1.6 km kablove të reja e tensionit të mesëm, vendosja e 12.5 km kablove të reja të tensionit të ulët, si dhe hapja e kanaleve.

Përfitues nga projekti "Taslixhe 4": 278 konsumatorë

Lokacionet kryesore ku do të punohet: Rr. Haxhi Zeka, Rr. Llapi dhe Rr. Azem Bejta

Periudha e zhvillimit të projektit: 2020 – 2021

Përfundimi i projektit: Korrik 2021

Gjatë zhvillimit të punimeve konsumatorët do të informohen paraprakisht 24-48 orë përmes uebfaqes, rrjeteve sociale dhe aplikacionit eKesco.

